



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2025:042942

Datë: 20.03.2025

Numri i dokumentit: 07022077

CN.nr.8/2025

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA DEÇAN, në procedurë jo kontesti morë e shkallës së parë më gjyqtarin Bekim Avdimetaj, sipas propozimit të propozuesit Q (S) T, nga J, për shpalljen e të zhdukur Z (S) T, nga J, për të vdekur, gjykata pas mbajtjes seancës të shqyrtimit përgatitorë me date 18.03.2025, në prani të propozuesit të përpiluar me date 20.03.2025 mure këtë:

A K T V E N D I M

I APROVOHET në tersi si i bazuar propozimi i propozuesit Q (S) T, nga J,.

II. VERTETOHET se i zhdukur, Z (S) T, nga J, i lindur me date 16.10.1924 në Junik, me banim në Junik, se është vdekur me date 28.07.1998 në Junik.

III. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi i zhdukuri Z (S) T, nga J, të regjistrohet si i vdekur.

IV. DETYROHET zyra e gjendjes civile në Junik, që në bazë të këtij aktvendimi në librin amzë për të vdekurve, të zhdukurin Zekë (Sali) Tofaj nga Juniku të regjistrohet si i vdekur.

A r s y e t i m

Propozuesi, Q (S) T, nga J, në propozim, seancën e shqyrtimit përgatitorë, më dt.18.03.2025 dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë propozimit të dorëzuar në gjykatë për shpalljen e të zhdukurit Z (S) T, nga J. Se babi im Z (S) T, që nga date 28.07.1998, është zhdukur nuk kemi me informacione se a gjindet i gjallë. Andaj i propozoj gjykatës që pas në dëgjimit edhe të dëshmitareve të propozuar në propozim të aprovoj propozimin për shpalljen e zhdukur Z (S) T, nga J, për të vdekur. Nuk i kërkoj shpenzimet e procedurës jo kontesti morë dhe hoqi dorë nga e drejta e ankesës.

Dëshmitari S. T, nga Juniku gjate seancës të shqyrtimit përgatitorë me date 18.03.2025 ka deklaruar se babi im Z. (S) T, që nga data 28.07.1998, është zhdukur nuk kemi me informacione se a gjendet i gjallë .

Dëshmitarin Sh. T, nga J, gjate seancës të shqyrtimit përgatitorë me date 18.03.2025 ka deklaruar se babi im Z. (S) T, që nga data 28.07.1998, është zhdukur nuk kemi me informacione se a gjendet i gjallë.

Gjykata sipas propozimit të propozuesit ka bërë administrimin e provave në lexohet propozimi i dorëzuar në gjykatë të propozuesit me datë 04.03.2025, lexohet ekstrakti me numër E 28547981 e lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Komunën e Junikut me datë 25.02.2025 i lindjes Z. T, i lindur me 16.03.1924, lexohet dëshmia e kryqit të kuq ndërkombëtar me numër të referencës BLG -803239-01 në emër të Z. T, i lindur me 16.10.1924 nga babi S. T, data e zhdukjes me 28.07.1998 në J, e lëshuar me datë 26.02.2025, lexohet ekstrakti i lindjes me numër E 28557447 në emër të S. T, i lindur me 15.08.1966 në J, e lëshuar nga zyra e gjendjes civile Gjakovë- Bec me 03.03.2025, lexohet ekstrakti i lindjes me numër E 28557454 në emër të Sh. T, i lindur me 5.03.1969 në J, e lëshuar nga zyra e gjendjes civile Gjakovë-Bec me 03.03.2025 të cilave fakteve që gjenden në shkresat e lëndës ja ka falur besimin.

Neni 2 par.1.1 Person i zhdukur është personi vendndodhja e të cilit është e panjohur për familjarët dhe kërkuesit e tij/saj dhe i cili në bazë të informacionit të besueshëm, është zhdukur në periudhën mes 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999 të Ligjit Nr. 04/L-023 për personat e zhdukur të Republikës së Kosovës

Nga sa u ta me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

NGA GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA DEÇAN CN.nr.8/2025 me date 20.03.2025

G J Y Q T A R I
Bekim Avdimetaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Pasi që propozuesi ka hequr dorë nga e drejta e ankesës, gjate seancës të shqyrtimit përgatitorë ky aktvendim behët i plotfuqishëm nga dita e marrjes së tij